



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1124/Prot.
1

Patos, më 22/05 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 19 MAJ 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Zharrëz

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjese publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i njësisë administrative Zharrëz z. Riza Hoxha, *rreth 24 pjesëmarrës (banorë dhe kryetarë të fshatrave)*

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të rishqyrtuar të gjitha kërkesat tuaja që keni paraqitur në dëgjesën e parë mbi kërkesat për hartimin e PBA-së. Nëse keni edhe ndonjë kërkesë shtesë mund ta paraqisni. Ju faleminderit!

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– përshëndetje të gjithëve! Siç e dini kjo tashmë është një detyrim ligjor dhe buxheti duhet të kalojë nëpërmjet një procesi sa më



**Drejtores e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e
kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

transparent. Në dëgjesën e parë janë marrë këto kërkesa nga ana juaj. Investime në infrastrukturë rrugore, bujqësi dhe ujësjellës, shtrim të rrugëve të parcelave, investime në KUZ, shërbimi i pastrimit të shtrihet në çdo lagje, ndërtimi i trotuarit për Verbasin, krahasitje e pemëve në Zharrëz, shtrimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit rrugor, azhormimi dhe certifikimi i tokës që kemi adresuar në institucionet përkatëse. Për rrugët dhe ujësjellsin vazhdojnë investimet, vazhdojnë rrugët e parcelave për të cilat është lidhur kontrata dhe po vazhdojnë sipas rëndësisë në terren. Për Verbasin që është kërkuar shtrimi i trotuarit është shtuar të kërkesat shtesë. Do të bëhet edhe njëherë rivlerësim i të ardhurave për këtë buxhet dhe do të futet në buxhet më pas. Krahasitja e pemëve është filluar dhe është në proces. Shtrimi i rrjetit rrugor është lidhur kontrata dhe po vazhdon si proces.

Drejtori i Shoqatës Ambjentaliste Zharrëz, Z. Qani Rredhi- Ne kemi kërkuar të shmangim ndonjë aksident të mundshëm me rrepet që janë këtu dhe përbëjnë rrezik për degët që mund të thyhen. Janë në rrugë kryesore dhe përbëjnë rrezik të madh, duhet ndërhyrë.



**Drejtor i Shoqatës Ambjentaliste Zharrëz Z.
Qani Rredhi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e
kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj– Krahastitja e pemëve do të përfundoj brenda kësaj jave e gjitha për zonën këtu.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e
kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

Banor i fshatit Verbas, z. Sefret Sina- përshëndetje! Është bërë një çarje rruge dhe po punohet nga bashkia dhe asnjë nuk është në dijeni në fshat. Ne duam të vendosemi në dijeni lidhur me punimet që kryhen në fshat dhe është bërë një kanal që është lënë në gjysëm pa përfunduar. Rrezikojmë të biem te dera e shtëpisë tonë. E dyta lidhur me pemët ne kemi vendosur në dijeni kryeplakun pasi na bien gjethet te shtëpia dhe bien degët e thata nga era.



**Banor i fshatit Verbas
z. Sefret Sina**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Kryetar i fshatit Verbas, z. Bilbil Çepele- Lidhur me këtë problem që paraqiti zotëria ka të



**Kryetar i fshatit Verbas
z. Bilbil Çepele**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028
dhe marrja e kërkesave buxhetore
për vitin 2026”**

Maj 2025

drejtë pasi unë si kryetarë fshati duhet të vendosen në dijeni lidhur me ndërhyrjet që bëhen në fshat. Gjithashtu duhet edhe qendra shëndetësore në Verbas, kanalet duhen pastruar dhe duhet ndriçimi.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Qendrat shëndetësore nuk janë kompetencë e bashkisë dhe nuk ndërhyjmë dot lidhur me këtë. Për pjesën tjetër do adresohen si probleme për ndërhyrje.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për
vitin 2026”**

Maj 2025

Drejtor i Shoqatës Ambjentaliste Zharrëz, Z. Qani Rredhi - Koshat e mbeturinave janë



**Drejtor i Shoqatës Ambjentaliste Zharrëz
Z. Qani Rredhi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e
kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

një problem i madh në zonë. Pse nuk janë vendosur koshat? Ne kemi pasur një projekt shumë të mirë për vendosjen e koshave 150 l në shtëpi për shërbim vetjak. Kjo do të ishte një zgjidhje shumë e mirë për banorët.

Banor i Zharrëzës, z. Enver Hasani- Meqë më ra rasti në këtë dëgjesë kam një problem shumë të madh lidhur me një objekt të vjetër të shtëpia. Ai është në gjendje të rrënuar dhe rrezikon të bjeri të vras ndonjë. Kërkoj të më zgjidhet kjo çështje. Gjithashtu kërkesat që kemi bërë për tombino të rrugët bujqësore pasi kemi shumë problem për të kaluar te Mjerakët.



**Banor i Zharrëzës
z. Enver Hasani**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Lidhur me tombinon do ta zgjidhim dhe do të mundohemi të ndërhyjmë sa më shpejt për të zgjidhur problemin të toka bujqësore.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- përshëndetje! Kemi problem me pastrimin e kanalit dhe të rrugëve. E kam ngritur këtë problem disa herë. Duhet të pastrohen kanalet dhe



**Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

më pas të shtrohet rruga Ferajve. Ajo rrugë është problem dhe kanali është pengesa pasi duhet të pastrohet. Edhe një problem tjetër lidhet me rrugën kryesore që lidhet me varrezat duhet pastruar bari pasi është në gjendje të keqe. Janë 19 familje që kanë tokat aty dhe pa u bërë kanali dhe të vendosen tumbinat ajo rrugë nuk shtrohet.

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Abedin Hoxha- Ka rreth dy muaj që nuk ka ndriçim në Zharrëz pasi janë djegur dritat. Për problemin e koshave lokalet i marrin mbeturinat dhe i hedhin në përrua. Prandaj duhen vendosur kosha të vegjël në lagje. Ujësijellsi ka lënë gropa pa mbuluar dhe kanale pa çakëll.



**Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja
e kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

Kryetar i Fshatit Frashër, z. Irakli Zarka- përshëndetje! Kërkesat e fshatit janë lidhur me zgjerimin e rrugës së fshatit dhe të bëhet me trotuar, nëse ka mundësi të bëhet një kanal në



**Kryetar i Fshatit Frashër
z. Irakli Zarka**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja
e kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

mënyrë që të zgjerohet rruga dhe shtrim i rrugës Llaq Kalabaçi. Duhet shtrim me asflat te rruga e re përballë shkollës në Frashër, shtrim i rrugës që lidhi dy rrugët nga Mokallarët dhe deri te lajthitë. Duhet një urë në proin Frashër që të bashkohen dy lagjet te rruga Mokallarët.

Banore e Zharrëzës, znj. Idajete Nuhaj- Unë ka një problem me tokën pasi duhen pastruar



**Banore e Zharrëzës
znj. Idajete Nuhaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

ferrat. Rruga për te parcela ime në Zharrëz duhet hapur pasi nuk hyn makina dhe uji më vjen i gjithë te ullinjte duke më shkaktuar shumë dëmtime në ullinj.

Gazetar z. Marin Nikolla- përshëndetje! Unë jam Marin Nikolla nga unioni i gazetarëve. Kemi një interes tjetër që janë fëmijët. Për Zharrëzën është premtuar që me një fond të bashkisë do të mund të vijnë në shkollë pa pagesë për transportin dhe nuk e di se sa është vendosur në dispozicion kjo gjë. Sipas interesit publik që është dëgjuar dhe me verifikimet nuk më del që është zbatuar kjo gjë.



**Gazetar
z. Marin Nikolla**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Zv/ kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Akoma nuk na ka ardhur një udhëzim nga Ministria lidhur me këtë çështje dhe sapo të vij një udhëzim patjetër që do të ndërmerren masa. Do të shikojmë edhe njëher këtë problem me ZVA.



**Zv/ kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Gazetar z. Marin Nikolla- Ju duhet të dërgoni një shkresë Ministrisë lidhur me këtë interes për fëmijët ose duhet të bëhet një marrëdhënie e dytë për tu zgjidhur kjo çështje. Kjo duhet të bëhet për çdo zonë ku fëmijët kanë nevojë. Gjithashtu projektet ndërkombëtare që vijnë unë mendoj që duhet të japin shërbim edhe në qytete të vogla. Si është marrëdhënia me këta projekte dhe grupet vulnerable?



**Gazetar
z. Marin Nikolla**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për
vitin 2026”**

Maj 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Me informacionet që unë kam
Ministria e Arsimit cakton një shumë të caktuar në bazë të largësisë së fëmijës nga shkolla



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja
e kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

dhe paguhet në llogarinë e prindit. Prindërit zakonisht kanë gjetur zgjidhje që kanë marrë
edhe furgona. Lidhur me projektet janë të gjitha në faqen zyrtare të bashkisë të publikuara.
Nëse nuk kemi diçka tjetër unë do ta deklaroja të ezauruar këtë dëgjese publike. Ju falenderoj
për pjesëmarrjen tuaj!

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

Foto nga dëgjesa publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

19 Maj 2025



